

Hapet thirrja për për stafin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në kuadër të programit Erasmus + në Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iași, në Rumani, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iași, në Rumani, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.

<http://www.uaic.ro/en/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë për mësimdhënie;
- Shkëmbimin e stafit ndihmës akademik me karakter administrativ / administrativ, me kohë të plotë, për trajnim;

Kohëzgjatja e bursave:

- 5 + 2 ditë;

Fushat e mësimdhënies:

- Histori dhe arkeologji;
- Filozofi dhe etikë;
- Edukim;
- Gjuhë të huaja;
- Shkenca sociale dhe të sjelljes (shkenca politike, sociologji, dhe studime kulturore, psikologji);
- Gazetari dhe raportim;
- Biznes dhe administrim;
- Drejtësi;
- Shkenca të Biologjisë;
- Shkenca të fizikës;
- Matematikë dhe statistikë;
- Teknologji informacioni dhe Komunikimi;

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik me kohë të plotë për mësimdhënie:

- CV+ Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën angleze);
- Certifikata e gjuhës së huaj (Anglisht B2);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer më parë një mobilitet Erasmus+ (dhe nëse po, ku);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/Teaching-Agreement_in-1.docx

*Plani i Mobilitetit është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin me kohë të plotë për trajnim:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);

- Vërtetim Punësimi (në gjuhën angleze);

- Certifikata e gjuhës së huaj (Anglisht B2);

- Vetëdeklarim nëse keni kryer më parë një mobilitet Erasmus+ (dhe nëse po, ku);

- Plani i mobilitetit për trajnim*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/Training-Agreement_in.docx

*Plani i Mobilitetit për trajnim është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së trajnimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat.

Afati për aplikim: 10 Nëntor 2022

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!